



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 280/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.07.2020, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e operatorit ekonomik “Nika” sh.p.k në procedurën e prokurimit me Nr.REF-53919-03-11-2020, me objekt: “Loti 6-*“Blerje furta dhe perime për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve”*, me fond limit: 159.533.664 lekë pa TVSH, zhvilluar me date 08.05.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.

Ankimues: “Dajti Park 2007” sh.p.k
L.Qesarake, Godine banimi dhe sherbimesh 3,4 kate + nencati + nencati + 2 kate bodrum, Kati 1, Tirane

Autoriteti Kontraktor: Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara
Sheshi Skënderbej, Nr.3, Tiranë

Subjekte të Interesuar: “Nika” sh.p.k
L.V. Shanto, Blv. Skenderbeu, god. 8-kateshe, kati I, Z.K 8593, Shkoder

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 12.03.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr.REF-53919-03-11-2020, me objekt: “Loti 6- “Blerje furta dhe perime për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve”, me fond limit 159.533.664 lekë pa TVSH, zhvilluar me date 08.05.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.

II.2. Në datën 28.05.2020 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar. Nga vlerësimi i bërë nga KVO-ja rezulton si më poshtë:

- | | |
|----------------------------|-----------------------------------|
| • “Nika” sh.p.k | 117.783.275,00 lekë, kualifikuar |
| • “Dajti Park 2007” sh.p.k | 119.780.720,00 lekë, kualifikuar |
| • “Sead SGS” sh.p.k | 122.203.089,00 lekë, skualifikuar |
| • “Shabani 2002” sh.p.k | 130.810.502,00 lekë, skualifikuar |

- “Sinani Trading” sh.p.k

154.022.240,00 lekë, skualifikuar

II.3. Në datën 04.06.2020, operatori ekonomik ankimes ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, nëpërmjet të cilës kundërshton kualifikimin e operatorit ekonomik “Nika” sh.p.k në procedurën e prokurimit. Konkretisht pretendohet si vijon:

“ [...]

Operatori ekonomik NIKA shpk i kualifikuar nga KVO, nuk ploteson kriteret kualifikuese të percaktuara në DST.

Konkretisht, nuk ploteson piken 1 mbi kapacitetin ligjor ku kerkohet: Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Licence të kategorise "II.1.A.1 - Prodhim, perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez", ose Licence të kategorise "II.1.B- Shitje me shumice e ushqimeve me origjine shtazore (per njerez)" në emer të tij, të leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (nuk lejohet përdorimi i Licences së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018).

Referuar konkurimeve tona të mëparshme si dhe të dhënave në faqen online të QKB, operatori Nika shpk nuk disponon asnjë license me vendndodhje aktive. Në fushën e ushqimeve ky operator disponon:

1- Licencën me numer serial LN-1085-03-2010 me kodin II 1.B "Shitje me shumice e produkteve me origjine shtazore (per njerez)", leshuar me dt 23/04/2010. Vendi i kryerjes së veprimtarisë për këtë license është "Qarku Shkoder, Rrethi Shkoder, Lagja Partizani, Tek Markata, Rus ". Referuar ekstraktit historik të shoqërisë Nika, shoqëria Nika shpk nuk ushtron aktivitet në adresën e licenses së mesipërme. Rrjedhimisht kjo license është e pavlefshme dhe pa vendodhje aktive. Kjo shoqëri ushtron aktivitet të pasqyruar në QKB vetëm në dy adresa të tjera të cilat janë hapur shumë me vone së data e leshimit të licenses II.1.B.

2- Licencën me numer serial LN-3194-04-2011 me kodin II.1.A.(1) "Prodhim, perpunim e shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez", leshuar me dt 05/04/2011. Vendi i kryerjes së veprimtarisë për këtë license është "Qarku Shkoder, Rrethi Shkoder, Tregu i shitjes me shumice i Fruta-Perimeve, Nr 4 ". Referuar ekstraktit historik të shoqërisë NIKA, shoqëria NIKA shpk nuk ushtron aktivitet në adresën e licenses së mesipërme. Rrjedhimisht kjo license është e pavlefshme dhe pa vendodhje aktive. Kjo shoqëri ushtron aktivitet të pasqyruar në QKB vetëm në dy adresa të tjera të cilat janë hapur shumë me vone së data e leshimit të licenses II.1.A.(1). Bashkelidhur ankesës ju dergojmë ekstraktin historik të shoqërisë NIKA printuar nga faqja online e QKB, Licensat e shoqërisë printuar nga faqja online e QKB, si dhe interpretime të ngjashme nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik printuar nga faqja online e këtij të fundit.

Operatori NIKA shpk nuk ploteson piken 1 të kapacitetit teknik në të cilën kerkohet: Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në vlerën prej të paktën 20 % të vlerës së fondit të marrëveshjes kuader të këtij Loti.

Operatori NIKA shpk nuk ploteson kriterin e mesipërme për furnizime të ngjashme në vlerën 20% të fondit limit. Kontratat e këtij subjekti me subjektet shtetërore nuk janë në harkun kohor të 3 viteve nga data e zhvillimit të procedurës, nderkohe që faturat tatimore të shitjes me subjekte

private nuk janë të së njëjtes natyre dhe kërkojmë verifikimin e vërtetësisë së tyre, duke qenë se prej mëse 3 vitesh ky operator nuk është aktiv në tregun e fruta-perimeve.

Operatori NIKA shpk nuk plotëson pikën 4 mbi kapacitetin teknik në të cilën kërkohej: Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë në pronësi ose në përdorim të paktën 1 (një) ambient të përshtatshëm për tregtimin ose magazinimin e mallrave objekt prokurimi, me sipërfaqe të paktën 200 m², për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës. Kontrata e paraqitur prej këtij operatori nuk është e regjistruar në QKB si adresë ushtrimi aktiviteti, nuk disponon Akt miratimi higjieno - sanitar për objektin e prokurimit si dhe nuk disponon Certifikatë për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin për objektin e prokurimit, lëshuar në emer të shoqërisë. Për sa më sipër argumentuam, kërkojmë pezullimin e vazhdimin të procedurës dhe s'kualifikimin e ofertes së shoqërisë NIKA shpk, si oferte me mangësi thelbësore në raport me DT.”

II.5. Nëpërmjet shkresës nr. 991/3 prot., datë 11.06.2020 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit si vijon:

“ [...]

1.Ofertuesi "Dajti Park 2007" SHPK ka ankimuar kualifikimin e ofertuesit "Nika" SHPK për mospërbushjen e kriterit në Shtojcën Nr.9 "Kriteret e Vecanta të kualifikimit" seksioni 2.1 "Kapaciteti ligjor/profesional i operatoreve ekonomike" pika 1 ndryshuar me shtojcën nr.1 në dokumentet e tenderit ku përcaktohet: "Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë Licence të kategorisë "II.A. I - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njëzë", ose Licence të kategorisë "II.1.B- Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njëzë)" në emer të tij, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018)."

Me pretendimin si vijon: [...]

Referuar konkurimeve tona të mëparshme si dhe të dhënave në faqen online të QKB, operatori Nika shpk nuk disponon asnjë license me vendndodhje aktive. Në fushën e ushqimeve ky operator disponon:

1- Licencën me numër serial LN-1085-03-2010 me kodin II 1.B "Shitje me shumicë e produkteve me origjinë shtazore (për njëzë)", lëshuar me dt 23/04/2010. Vendi i kryerjes së veprimtarisë për këtë license është "Qarku Shkoder, Rrethi Shkoder, Lagja Partizani, Tek Markata, Rus". Referuar ekstraktit historik të shoqërisë Nika, shoqëria Nika shpk nuk ushtron aktivitet në adresën e licenses së mësipërme. Rrjedhimisht kjo license është e pavlefshme dhe pa vendndodhje aktive. Kjo shoqëri ushtron aktivitet të pasqyruar në QKB vetëm në dy adresa të tjera të cilat janë hapur shumë me vonë se data e lëshimit të licenses II.1.B.

2- Licencën me numër serial LN-3194-04-2011 me kodin II.1.A.(1) "Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njëzë", lëshuar me dt 05/04/2011. Vendi i kryerjes së veprimtarisë për këtë license është "Qarku Shkoder, Rrethi Shkoder, Tregu i shitjes me shumicë i Fruta-Perimeve, Nr 4 ". Referuar ekstraktit historik të shoqërisë NIKA, shoqëria NIKA shpk nuk ushtron aktivitet në adresën e licenses së mësipërme. Rrjedhimisht kjo license është e

pavlefshme dhe pa vendodhje aktive. Kjo shoqeri ushtron aktivitet te pasqyruar ne QKB vetem ne dy adresa te tjera te cilat jane hapur shume me vone se data e leshimit te licenses II.1.A(1). Bashkelidhur ankeses ju dergojme ekstraktin historik te shoqerise NIKA printuar nga faqja online e QKB, Licensat e shoqerise printuar nga faqja online e QKB, si dhe interpretime te ngjashme nga ana e Komisionit te Prokurimit Publik printuar faqja online e ketij te fundit.

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vleresimin e bere ne sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave, dokumentet e dorezuara nga ofertuesi "Nika" SHPK, pretendimet e parashtruara ne ankesa mbi kualifikimin e ofertes se tij nga ofertuesi "Dajti Park 2007" SHPK konstatoi se:

Per ofertuesin "Nika" SHPK, Komisioni i Vleresimit te Ofertave ka njoftuar automatikisht nepermjet sistemit te prokurimit elektronik me date 28.05.2020, kualifikimin e tij.

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, verifikoi ne sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjese e ofertes ekonomike nga Ofertuesi "Nika" SHPK dhe konstatoi:

Ne dokumentat e tenderit ne Shtojcen Nr.9 "Kriteret e Vecanta te kualifikimit", seksioni 2.1 "Kapaciteti ligjor/profesional i operatoreve ekonomike", pika 1, percaktohet se operatori ekonomik pjesemarres duhet te paraqesë Licence te kategorise "II.I.A.I - Prodhim, perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez", ne emer te tij te leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (nuk lejohet perdorimi i Licences se nje operatori tjeter ekonomik, sipas Rekomandimit te perbashket te APP-se dhe AKU-se te dates 19.11.2018).

Nepermjet publikimit te Shtojces nr. 1 "Per modifikimin e dokumenteve te tenderit per proceduren e prokurimit, Tender i Hapur mbi kufirin e larte monetar, Marreveshje Kuader me disa operatore ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara, me afat te Marreveshjes Kuader 24 muaj me objekt "Blerje artikuj ushqimore, per Drejtorine e Pergjithshme te Burgjeve", e ndare ne 6 (gjashte) Lote, me fond limit 1,008.096.397 (njemiliard e tete milion e nentedhjet e gjashte mije e treqind e nentedhjet e shtate) Leke (pa TVSH), dhe REF-53906-03-11-2020," eshte bere ndryshimi i kriterit si vijon: "Operatori ekonomik pjesemarres, duhet te paraqes Licence te kategorise "II.1.A.1 - Prodhim, perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez", ose Licence te kategorise "II.1.B- Shitje me shumice e ushqimeve me origjine shtazore (per njerez)" ne emer te tij, te leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (nuk lejohet perdorimi i Licences se nje operatori tjeter ekonomik, sipas Rekomandimit te perbashket te APP-se dhe AKU-se te dates 19.11.2018)."

Nga verifikimi i sistemit te prokurimit elektronik rezulton se ofertuesi "Nika" SHPK ne permbushje te kriterit te percaktuar ne Shtojcen Nr.9 "Kriteret e Vecanta te kualifikimit" seksioni 2.1 "Kapaciteti ligjor/profesional i operatoreve ekonomike", pika 1, Licensen me kodin II.1.B me objekt "Shitje me shumice e produkteve me origjine shtazore (per njerez)", si dhe Licensen me kodin II.1.A.(1) me objekt "Prodhim, perpunim e shpemdardje me shumice e ushqimeve per njerez".

Ne lidhje me pretendimet e ankimuesit, sqarojme se: Ne shtojcen nr.1 eshte percaktuar se Operatori ekonomik pjesemarres, duhet te paraqes Licence te kategorise "II.1.A.1 - Prodhim, perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez", ose Licence te kategorise "II.1.B- Shitje me shumice e ushqimeve me origjine shtazore (per njerez)" ne emer te tij,

te leshuar nga Qendra Kornbetare e Biznesit (nuk lejohet perdorimi i Licences se nje operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të perbashket të APP-se dhe AKU-se të dates 19.11.2018), ofertuesi "Nika" SHPK ka sjelle dokumentacion ne perputhje me kerkesat e dokumentave të tenderit.

Ne nenin 53 të ligjit nr. 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" i ndryshuar, pika 3 "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlereson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në perputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e percaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me percaktimet e nenit 54 të këtij ligji."

Gjithashtu sqarohet se nga verifikimi në faqen e Qendres Kombetare të Biznesit licensat e dorezuara nga ofertuesi "Nika" SHPK rezultojnë aktive.

Per arsyet e më sipërme pretendimi i ofertuesit "Dajti Park 2007" SHPK nuk pranohet.

2. Ofertuesi "Dajti Park 2007" SHPK ka ankimuar kualifikimin e ofertuesit "Nika" SHPK për mospermbushjen e kriterit në Shtojcën Nr.9 "Kriteret e Vecanta të kualifikimit" seksioni 2.3 "Kapaciteti teknik" pika 1 në dokumentet e tenderit ku percaktohet: "Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në vlerën prej të paktën 20 % të vlerës së fondit të marrëveshjes kuader të këtij Loti. Këto furnizime të ngjashme duhet të vertetohen me dokumentacionin si më poshtë: a) Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vertetime të leshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shenohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara, b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën perkatese tatimore të shitjes ku të shenohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara. "

Me pretendimin si vijon: [...] "Operatori NIKA shpk nuk plotëson kriterin për furnizime të ngjashme në vlerën 20% të fondit limit. Kontratat e këtij subjekti me subjektet shtetërore nuk janë brenda 3 viteve nga data e zhvillimit të procedurës, ndërkohë që faturat tatimore të shitjes me subjekte private nuk janë të së njëjtes natyre dhe kërkojnë verifikimin e vertetësise së tyre, duke qenë se prej mëse 3 vitesh ky operator nuk është aktiv në tregun e fruta-perimeve." Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vlerësimin e bërë në sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, dokumentet e dorezuara nga ofertuesi "Nika" SHPK, pretendimet e parashtruara në ankesë mbi kualifikimin e ofertes së tij nga ofertuesi "Dajti Park 2007" SHPK konstatoi se:

Per ofertuesin "Nika" SHPK, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka njoftuar automatikisht nepermjet sistemit të prokurimit elektronik me datë 28.05.2020, kualifikimin e tij.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, verifikoi në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjesë e ofertes ekonomike nga Ofertuesi "Nika" SHPK dhe konstatoi:

Në dokumentat e tenderit në Shtojcën Nr.9 "Kriteret e Vecanta të kualifikimit", seksioni 2.3 "Kapaciteti teknik", pika 1, percaktohet se operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në vlerën prej të paktën 20 % të vlerës së fondit të marrëveshjes kuader të këtij Loti. Këto furnizime të ngjashme duhet të vertetohen me dokumentacionin si më poshtë: a)

Autoriteti kontraktor si deshmi per pervojen e meparshme kerkon vertetime te leshuara nga nje ent publik ose fatura tatimore te shitjes, ku shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara, b) Kur furnizimet e ngjashme jane realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet te paraqese faturen perkatese tatimore te shitjes ku te shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara.

Nga verifikimi i sistemit te prokurimit elektronik rezulton se ofertuesi "Nika" SHPK ne permbushje te kriterit te percaktuar ne piken 1 ne seksionin 2.3 "Kapaciteti Teknik" per te deshmuar per furnizimet e meparshme te ngjashme, te kryera gjate 3 (tre) viteve te fundit nga data e zhvillimit te procedures, ka dorezuar fatura tatimore shitje. Nga verifikimi i fatura te dorezuara rezulton se ofertuesi ka pambushur kriterin ne vleren prej te pakten 20 % te vleres se fondit te marreveshjes kuader te ketij Loti.

Per arsyet e me sipërme pretendimi i ofertuesit "Dajti Park 2007" SHPK nuk pranohet.

3. Ofertuesi "Dajti Park 2007" SHPK ka ankimuar kualifikimin e ofertuesit "Nika" SHPK per mospermbushjen e kriterit ne Shtojcen Nr.9 "Kriteret e Vecanta te kualifikimit" seksioni 2.3 "Kapaciteti teknik" pika 4 ne dokumentet e tenderit ku percaktohet: "Operatori ekonomik pjesemarres, duhet te kete ne pronesi ose ne perdorim te pakten 1 (nje) ambient te pershtatshem per tregtimin ose magazinimin, e mallrave objekt prokurimi, me siperfaqe te pakten 200 m2, per te cilin duhet te paraqes dokumentacionin perkates, si me poshte: a) Dokumentacioni qe verteton pronesine ose huaperdorjen ose qiramarrjen: Dokumentacioni qe verteton pronesine: Certifikata e pronesise e leshuar nga institucioni i autorizuar me ligj / kontrata e shitblerjes / kontrata e dhurimit / cdo dokument tjeter me ane te se cilit fitohet e drejta e pronesise sipas Kodit Civil te Republikes se Shqiperise. Dokumentacioni qe verteton huaperdorjen: Kontrate noteriale huaperdorje. Dokumentacioni qe verteton marrjen me qira: Kontrate noteriale qiraje. b) Akt miratimi higjengo - sanitar per kete ambient, leshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj. c) certifikate per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin, leshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj. d) Operatori ekonomik pjesemarres, duhet te deklaroje plotesimin e standarteve tekniko-teknologjike per kete ambient. e) Foto te ambientit te brendshem te prodhimit ose tregtimit ose magazinimit, te mallrave objekt prokurimi ..."

Me pretendimin si vijon: [...] "Kontrata e paraqitur prej ketij operatori nuk eshte e regjistruar ne QKB si adrese ushtrim aktiviteti, nuk disponon akt miratimi higjengo-sanitar per objektin e prokurimit si dhe nuk disponon certifikate per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin per objektin e prokurimit leshuar ne emer te shoqerise. "

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vleresimin e bere ne sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave, dokumentet e dorezuara nga ofertuesi "Nika" SHPK, pretendimet e parashtruara ne ankesa mbi kualifikimin e ofertes se tij nga ofertuesi "Dajti Park 2007" SHPK konstatoi se:

Per ofertuesin "Nika" SHPK, Komisioni i Vleresimit te Ofertave ka njoftuar automatikisht nepermjet sistemit te prokurimit elektronik me date 28.05.2020, kualifikimin e tij.

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, verifikoi ne sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjese e ofertes ekonomike nga Ofertuesi "Nika" SHPK dhe konstatoi:

Ne dokumentat e tenderit ne Shtojcen Nr.9, "Kriteret e Vecanta te kualifikimit", seksioni 2.3 "Kapaciteti teknik", pika 4, percaktohet se operatori ekonomik pjesemarres, duhet te kete ne pronesi ose ne perdorim te pakten 1 (nje) ambient te pershtatshem per tregtimin ose magazinimin, e mallrave objekt prokurimi, me siperfaqe te pakten 200 m2, per te cilin duhet te paraqes dokumentacionin perkates, si me poshte: a)Dokumentacioni qe verteton pronesine ose huaperdorjen ose qiramarrjen: Dokumentacioni qe verteton pronesine: Certifikata e pronesise e leshuar nga institucioni i autorizuar me ligj / kontrata e shitblerjes / kontrata e dhurimit / cdo dokument tjeter me ane te se cilit fitohet e drejta e pronesise sipas Kodit Civil te Republikes se Shqiperise. Dokumentacioni qe verteton huaperdorjen: Kontrate noteriale huaperdorje, Dokumentacioni qe verteton marrjen me qira: Kontrate noteriale qiraje. b) Akt miratimi higjeno - sanitar per kete ambient, leshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj. c) Certifikate per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin, leshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj. d) Operatori ekonomik pjesemarres, duhet te deklaroje plotesimin e standarteve tekniko-teknologjike per kete ambient. e) Foto te ambientit te brendshem te prodhimit ose tregtimit ose magazinimit, te mallrave objekt prokurimi.

Nga verifikimi i sistemit te prokurimit elektronik rezulton se ofertuesi "Nika" SHPK ne permbushje te kriterit te percaktuar ne Shtojcen Nr.9, "Kriteret e Vecanta te kualifikimit", seksioni 2.3 "Kapaciteti teknik", pika 4, ne dokumentet e tenderit ka dorezuar dokumentin "Certifikata e pronesise". Pjese e dokumentacionit te dorezuar nga ky ofertues eshte dhe leje miratimi higjeno - sanitar per kete ambient, leshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj, si dhe Certifikate per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin, leshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

Per arsyet e mesiperme pretendimi i ofertuesit "Dajti Park 2007" SHPK nuk pranohet."

II.6. Në datën 18.06.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt si edhe në autoritetin kontraktor.

II.7. Në datën 02.07.2020 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 601/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 1157/1 prot., datë 26.06.2020, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik "Dajti Park 2007" sh.p.k se: "Operatori NIKA shpk nuk ploteson piken 1 te kapacitetit teknik ne te cilen kerkohet: Operatori ekonomik duhet te paraqese deshmi per furnizimet e meparshrne te ngjashme, te kryera gjate 3 (tre)

viteve te fundit nga data e zhvillimit te procedures, ne vleren prej te pakten 20 % te vleres se fondit te marreveshjes kuader te ketij Loti.

Operatori NIKA shpk nuk ploteson kriterin e mesiperm per furnizime te ngjashme ne vleren 20% te fondit limit. Kontratat e ketij subjekti me subjektet shteterore nuk jane ne harkun kohor te 3 viteve nga data e zhvillimit te procedures, nderkohe qe faturat tatimore te shitjes me subjekte private nuk jane te se njejtes natyre dhe kerkojme verifikimin e vertetesise se tyre, duke qene se prej mese 3 vitesh ky operator nuk eshte aktiv ne tregun e fruta-perimeve”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 1 e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit, nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesave si më poshte vijon:

- 1) **Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në vlerën prej të paktën 20 % të vlerës së fondit të marrëveshjes kuadër të këtij Loti.** Këto furnizime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
- a) Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.1.2. Në shtojcën 10 “Specifikimet teknike” të dokumentave të tenderit rezulton se është kërkuar si vijon:

LOTI 6 “BLERJE FRUTA DHE PERIME”

1. BIZELE

Bazuar në SSH 1713:1988 ose ekuivalentin e tij.

Klasifikimi:

- **Lloji: Cilësi e parë, bizele e njomë (kokërr) e freskët**

Kërkesat cilësore

Treguesit shqisorë:

- **Pamja e jashtme:** të njoma, të freskëta, të pastra, me ngjyrë të kultivarit, me pjekuri teknike dhe madhësi normale të kultivarit.
- **Dëmtime mekanike,** njolla ndryshku, nga antraknoza, ndezje e kalbje: lejohen të vrara deri 5 % e masës. Nuk lejohen me njolla ndryshku nga antraknoza, ndezje e kalbje.

Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi

Sipas SSH 1799:1988 “Perime. Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi”, ose ekuivalentin e tij.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.

Transporti i perimeve të freskta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjeno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

2. BIZELE

Bazuar në SSH 1713:1988 ose ekuivalentin e tij.

Urdhër i Ministrisë së Bujqësisë Nr 645, dt. 23.12.2016, Për zëvendësimin e aneksit I, të Urdhërit nr. 234, datë 20.05.2014, Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”.

Klasifikimi

- **Lloji: Bizele e ngrirë kokërr , cilësi e parë**

Kërkesat cilësore

- Pamja e jashtme dhe konsistenca: Të pastra, me përmbajtje të lehtë pjesësh të bishtajës për shkak të përpunimit mekanik ,të ngrira në qese, me konsistencë, të fortë e të ngjitura në bllok, por që me goditje shkrihen, me kristale akulli, me pjekuri teknike.
- Ngjyra: karakteristike e kultivarit.
- Shija dhe aroma: me shije e aromë karakteristike të bizeles. Pa shije të thartë, pa aromë të huaj, pa erë myku.
- Madhësia e kokrrës: normale sipas kultivarit.
- Dëmtime mekanike: lejohen deri në 5 %.
- Të kalbura, të prekura nga sëmundjet e insektet: nuk lejohen.

Dokumentacioni shoqërues:

Analizë mikrobiologjike (bazuar në urdhrin nr. 645, datë 23.12.2016).

Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi

Sipas SSH 1799:1988 “Perime. Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi”, ose ekuivalentin e tij.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit. Ambalazhimi bëhet në qeska plastike, me masa sipas kërkesave të AK-së.

Mbi çdo ambalazh vendoset etiketa ku shënohen:

- Emërtimi i prodhuesit,
- Emri i produktit,
- Pesha neto,
- Data e prodhimit,
- Data e skadimit,
- Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Transporti të bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga faktoret atmosferike duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore dhe që nuk ndikojnë në karakteristikat dhe cilësinë e produktit dhe sigurojnë ruajtjen e tij higjienike.

Verifikimi i kërkesave cilësore

Duhet të shoqërohet me raport analizë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Raport Analiza “Mikrobiologjike” duhet të paraqitet në origjinal, ose fotokopje të noterizuara.

3. BARBUNJA

Bazuar në SSH 1760:1988 ose ekuivalentin e tij.

Klasifikimi

- **Lloji: Cilësi e parë, e freskët**

Kërkesat cilësore

- Pamja e jashtme dhe ngjyra: Të njoma, të freskëta, pa fije, me ngjyrë tipike për kultivarin.
- Kokrra të ndezura, të shtypura e të mykura: nuk lejohen të vyshkura.
- Dëmtime mekanike: lejohen deri në 3% e partisë me dëmtime të lehta (të çara ose të thyera).
- Njolla ndryshku, në % jo më shumë se: nuk lejohen.
- Nga sëmundjet e solucionet kimike, nuk lejohen.

Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi

Sipas SSH 1799:1988 “Perime. Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi” ose ekuivalentin e tij.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.

Transporti i perimeve të freskëta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

4. BAMJE

Bazuar në SSH 1491: 1987 ose ekuivalentin e tij.

Klasifikimi:

- **Lloji: Cilësi e parë, e freskët**

Kërkesat cilësore

Treguesit shqisorë:

- Pamja e jashtme: Të freskëta, të shëndosha, të pastra, me fije normale për kultivarin dhe fara që duket lehtë, me formë të drejtë, lehtësisht të deformuar. Forma të jetë e një prizmi shumëkëndësh që ngushtohet në majë, të pa drunjëzuara e pa fije.
- Gjatësia për bamjen frutshkurtër të jetë deri në 6 cm dhe për atë frutgjatë të jetë deri në 8 cm.
- Dëmtime të ndryshme (mekanike, sëmundje nga kimikatet): Lejohet deri në 5 % të partisë me vyshkje të lehtë. Nuk lejohet me sëmundje e dëmtues.
- Ngjyra të jetë tipike për kultivarin.
- Ndërtimi i frutit: Fruti të jetë i butë, me fara të vogla në fazën e qumështit. Lejohet me fruta të tejpyjekura deri në masën 2% për cilësinë e parë.

Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi

Sipas SSH 1799:1988 “Perime. Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi” ose ekuivalentin e tij.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.

Transporti i perimeve të freskta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjienike – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

5. PRESH

Bazuar në SSH 1759:1988 ose ekuivalentin e tij.

Klasifikimi

- **Lloji : cilësi e parë, e freskët**

Treguesit cilësorë

- Pamja e jashtme: I freskët, i njomë, i pastër, me ngjyrë të bardhë në jeshile, i pa vyshkur dhe i larë me ujë të pijshëm.
- Diametri në pjesën më të trashë, cm: Mbi 2,5 - 3,5.
- Gjatësia e kërcellit, cm: 25 – 45.
- Gjatësia e gjethit nga rozeta, cm, jo më shumë se: 20.
- Sistemi rrënjor, cm, jo më shumë se: 1.
- Dëmtime e sëmundje: Nuk lejohen.

Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi

Sipas SSH 1799:1988 “Perime. Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi ose ekuivalentin e tij.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.

Transporti i perimeve të freskta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjienike – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

6. SPINAQ

Bazuar në SSH 1757:1988 ose ekuivalentin e tij.

Klasifikimi

- **Lloji : cilësi e parë, e freskët**

Treguesit cilësorë

- Pamja e jashtme: Me gjethe të njoma e të freskëta, me ngjyrë jeshile karakteristike e kultivarit. Të lara e të pastruara me ujë të pijshëm e pa lulëzim.
- Gjatësia e tufës, cm:
 - o Për spinaqin e serrës: Mbi 30.
 - o Për spinaqin e fushës: Mbi 20-30.
- Sistemi rrënjor, cm, jo më shumë se: 1.
- Të prekura nga sëmundjet, të vyshkura, të mykura e të kalbura: Nuk lejohen.

Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi

Sipas SSH 1799:1988 “Perime. Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi” ose ekuivalentin e tij.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.

Transporti i perimeve të freskta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjienike – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

7. DOMATE

Bazuar në SSH 1726:1988 ose ekuivalentin e tij.

Klasifikimi

- **Lloji : cilësi e parë, e freskët**

Treguesit cilësorë

- Pamja e jashtme: Të freskëta, me forme tipike të kultivarit, të plota, të pastra, të pavrara, të pashtypura, pa kalbje dhe pa njolla nga djegia e diellit, të paprekura nga sëmundjet dhe dëmtuesit si dhe të pa lagura.
- Pjekuria dhe ngjyra: Me pjekuri normale, me ngjyrë të kuqe, lehtësisht rozë dhe jeshile rreth bishtit. Nuk lejohen domate të tejpkjekura, të zbutura e të vyshkura.
- Dëmtime e sëmundje: Nuk lejohen.
- Të plasura e të vrara lehtësisht: Për llojet e mesme e të vona lejohet deri 5 % plasaritje rreth bishtit por pa rrjedhje lëngu (të kalçifikuara).
- Madhësia e kokrrës (diametri më i madh gjerësor), cm, jo më pak se:
 - Për të hershmet: 5.
 - Për të mesmet e të vonat: 7.
 - Për të mesmet e të vonat
 - ore (gjatësia): 5.

Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi

Sipas SSH 1799:1988 “Perime. Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi” ose ekuivalentin e tij.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.

Transporti i perimeve të freskta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjienike – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

8. QEPE E THATË

Bazuar në SSH 1468:1987 ose ekuivalentin e tij.

Klasifikimi:

- **Lloji: Cilësi e parë**

Kërkesat cilësore

Treguesit shqisorë:

9. Pamja e ngjyra: Karakteristikë e qepës së bardhë të tharë pa pjesë të karamelizuara. Në formë sektori rrethor me trashësi 2-5 mm. Lejohen copa me përmasa të vogla deri në 5 % e sasisë.

10. Shija dhe era: Karakteristikë e qepës pa shije dhe erë të huaj.

Treguesit fiziko-kimik:

11. Lagështia jo më shumë se 8 %.

12. Lëndë të huaja nuk lejohen.

13. Ngarkesa mikrobiale: brenda normave të lejuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

14. Të ngrira, të kalbura dhe të mykura nuk lejohen.

Ambalazhimi dhe etiketimi

Qepët vendosen në arka kartoni në sasi sipas kërkesave të AK-së.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organoleptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.

Mbi çdo ambalazh vendoset etiketa ku shënohen:

- Emërtimi i prodhuesit,
- Emri i produktit,
- Pesha neto,
- Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Verifikimi i kërkesave cilësore

Marrja në dorëzim bëhet me parti. Parti konsiderohet sasia e qepës së thatë me karakteristika të njëjta, e prodhuar nga i njëjti prodhues dhe që dorëzohet njëherësh.

Çdo parti shoqërohet me fletë analizë laboratorike.

Duhet të shoqërohet me raport analizë të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Raport Analiza “Fiziko-Kimike” duhet të paraqitet në origjinal, ose fotokopje të noterizuara.

Ruajtja dhe transportimi

Qepa e thatë e ambalazhuar si më sipër ruhet në ambiente të errëta dhe të thata, të ajrosura mirë, me temperaturë deri në 25°C dhe lagështi relative jo më shumë se 75%.

Thasët ose kutitë vendosen në stiva mbi skelaturë druri deri në largësi rreth 25 cm nga dyshemetë dhe 50 cm larg mureve. Ambientet të dezinfektohen herë pas here.

Transporti i perimeve bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

Qepa e prodhuar dhe e ruajtur në kushtet e përcaktuara në këtë standart garantohet nga prodhuesi për 8 muaj nga data e prodhimit.

1. QEPË E NJOMË

Klasifikimi

- **Lloji : cilësi e parë, e freskët**

Treguesit cilësorë

- Kërkohet cilësia e parë, të jenë të njoma, të freskëta, të pastra, të lara me ujë të pijshëm, me ngjyrë jeshile të gjetheve, të pa çara, të pa vyshkura dhe pa karabush.
- Gjatësia e tufës të jetë pa kufizim dhe me bishta të pa prera.
- Dëmtime mekanike nuk lejohen.
- Gjethet të verdha dhe të lagura, karabush të mëdhenj, të gjatë dhe të kalbur nuk lejohen.

Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi

Sipas SSH 1799:1988 “Perime. Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi” ose ekuivalentin e tij.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.

Transporti i perimeve të freskta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjienike – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

2. PATATE

Bazuar në SSH 1729:1990 ose ekuivalentin e tij.

Klasifikimi

- **Lloji : cilësi e parë, e freskët**

Treguesit cilësorë

- Pamja e jashtme: Të plotë, të shëndosha, jo të jeshilosur, të pastër, të pa mbirë, të një ngjyre e forme karakteristike të kultivarit. Zhardhokët të njëjtë në formë e ngjyrë.
 - a) Zhardhokë të jeshilosur në 1/3 e sipërfaqes, %, të masës, jo më shumë se: 1.
 - b) Zhardhokë të vyshkur, %, të masës, jo më shumë se: 2.
 - c) Zhardhokë me lëkurë të zhveshur deri 1/3 e sipërfaqes, %, e masës, jo më shumë se:
 - Për veroret: 10.
 - Për dimëroret: 15.
- Lëndë minerale (gurë, etj. %, të peshës, jo më shumë se: Nuk lejohen.
- Përmbajtja e nitrateve mg/ kg, jo më shumë se: 250.
- Dëmtime, %, e numrit të zhardhokëve, jo më shumë se:
 - Të çara, të prera e të plasura nga goditjet nuk lejohen: Nuk lejohen.
 - Të mbira:
 - Për veroret: Nuk lejohen.
 - Për dimëroret: 1.
 - Nga krymbi tel: Nuk lejohen.
 - Nga djegie dielli: Nuk lejohen.
 - Nga bryma e ngrirje: Nuk lejohen.
 - Nga sëmundje:
 - Kroma e njolla ndryshku: 1.
 - Këmbëzezë, kalbëzim unazor etj., sëmundje të tulit: Nuk lejohen.
 - Të kalbura: Nuk lejohen.

Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi

Sipas SSH 1799:1988 “Perime. Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi” ose ekuivalentin e tij.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.

Transporti i perimeve të freskta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjienike – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

3. LAKËR E BARDHË

Bazuar në SSH 1758:1988 ose ekuivalentin e tij.

Klasifikimi

- **Lloji : cilësi e parë, e freskët**

Treguesit cilësorë

- **Pamja e jashtme:** Të zhvilluara, me mbështjellje fletësh, e fortë në prekje. Lejohen lakra të pangjeshura deri: 5 % të partisë.
- **Pastrimi dhe gjatësia e koçanit:** Të jenë të pastruara dhe me 2 – 3 gjethe të gjelbëra, të lidhura me koçanin, i cili të jetë deri në 3 cm.
- **Dëmtime të ndryshme mekanike, sëmundje e të çara të lehta:** Lejohen deri 5 % e partisë me dëmtime të lehta mekanike, të çara lehtësisht e të shpërthyera si dhe të dëmtuara lehtësisht nga bryma. Me sëmundje nuk lejohen.
- **Pesha e kokrrës:**
 - a) Për lakrën e hershme: Jo më pak se 1 kg.
 - b) Me pjekje të mesme e të vona: Jo më pak se 1.5 kg.
 - c) Për lakrën tip “Drinishti”, hibride etj: Jo më pak se 0.8 kg.

Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi

Sipas SSH 1799:1988 “Perime. Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi” ose ekuivalentin e tij.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.

Transporti i perimeve të freskta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

4. SPECA

Bazuar në SSH 1756:1988 ose ekuivalentin e tij.

Klasifikimi

- **Lloji : cilësi e parë, e freskët**

Treguesit cilësorë

- **Pamja e jashtme:** Me ngjyrë e formë tipike të kultivarit, të freskëta, të pastra dhe me pjekuri teknike.
- **Dëmtime (të shtypura, të gërvishtura), %, jo më shumë se:** 3.
- **Shija:** Karakteristike e kultivarit. Nuk lejohet përzierje e specave djegës me ato jo djegës.
- **Gjatësia, cm:**
 - o Për të gjatat: Mbi 10.
 - o Për të rrumbullaktat: Mbi 7.

Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi

Sipas SSH 1799:1988 “Perime. Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi” ose ekuivalentin e tij.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.

